



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8698 / Prot. 23

Divjakë më 19 / 08 / 2025

Lënda:

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK
DIVJAKË, MUAJI GUSHT 2025 ”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, Ju njoftojmë se: **Më datë: 27 .08. 2025, ditën e Mërkur ora 10:00,** në Sallën e Mbledhjeve, pranë Shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin **Gusht 2025**”. **Me këtë Rend dite:**

1. Miratim i Rendit të Ditës.
2. Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 25.06.2025
3. Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Korrik 2025
4. **Projekt-vendim** - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga Fondi i kushtëzuar deri 6% “ për bllok ndihmën “ për muajin Korrik 2025.
5. **Projekt-vendim** - Për miratimin e Planit Social 2025-2028 për Bashkinë Divjakë.
6. **Projekt-vendim.**- Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2025-2030.
7. **Projekt-vendim.** Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve, Bashkia Divjakë, 2025-2029.
8. **Projekt-vendim.** Për miratimin e Planit të mbarështrimit të pyjeve të Bashkisë Divjakë, 2025-2030.
9. **Projekt-vendim.** Për miratimin e Planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore, 2025-2030.
10. **Projekt-vendim.** Për përditësimin e pasurisë me nr 15 të listës së inventarit të pronave të kaluara ne pronësi/përdorim të Bashkisë Divjakë me VKM nr 499 datë, 19.07.2006.
11. **Projekt-vendim.** Për miratimin e përfundimit të proçedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
12. **Projekt-vendim.** Për miratimin e Marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajnimit të njësisë të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.(TALGA)
13. **Zgjedhja e Zëvendës Kryetarit të Këshillit Bashkiak Divjakë.**
- Propozimi i kandidatëve për Zëvendës Kryetar të Këshillit. - Përgatitja dhe procedurat e votimit; - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e Zëvendës Kryetarit të Këshillit Bashkiak Divjakë.

Shënimi: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:

-Për pikat Nr: **4, 12**, Komisioni i Ekonomisë dhe i financave. -Për pikat Nr: **6**, Komisioni i Arsimit, Rinisë, kulturës, sporteve dhe turizmit. -Për pikat Nr: **5,9**, Komisioni i Shëndetësisë, i mbrojtjes sociale, dhe barazisë gjinore. -Për pikat Nr: **7,8**, Komisioni i bujqësisë, pyjeve, mbrojtjes së mjedisit dhe emergjencat civile. -Për pikat Nr: **10,11**, Komisioni i Urbanistikës dhe infrastrukturës.

Sqarim nga Sekretari: Për sa i perket Planeve të mësipërme, i keni të publikuara në faqen e webit të Bashkisë.

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Liri Biti

